# Petrit Çano

DREJTUES I PROKURORISË SË RRETHIT GJYQËSOR KRUJË

Deklaratat e analizuara:

**15 Deklarata të analizuara**

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2017)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017




Rritja e Pasurisë Bruto është 4.6 herë

+ 1,164,627 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë

## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

Likuiditete në Bankë







Likuiditete në Cash

Pasuritë e Paluajtshme







Huadhënie

## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

| Të Ardhurat 2004-2017 | Shuma në Lekë | Raporti në % |
|---|---|---|
| Paga dhe shpërblime nga funksioni | 19,746,921 | 52.78% |
| Të ardhura nga paga e familjarëve | 7,300,386 | 19.51% |
| Mësimdhënia | 1,216,250 | 3.25% |
| Të ardhura nga biznesi, kopësht për fëmijë, në emër të bashkëshortes | 3,400,000 | 9.09% |
| Fitimi nga shitja e pasurive të paluajtshme | 4,150,000 | 11.09% |
| Të ardhura nga Qira | 200,000 | 0.53% |
| Të ardhura të tjera | 1,400,000 | 3.74% |
| Total | 37,413,557 | 100% |

## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

**2 Me probleme**
**12 Pa Probleme**

Subjekti Petrit Çano rezulton me pasuri të pajustifikuar për dy vite, konkretisht për vitin 2009 shuma e pajustifikuar me burimet e deklaruara është 1,845,427 lekë, ndërsa për vitin 2011 është 1,502,319 lekë.
Në vitin 2006, subjekti deklaron shpenzime qeraje 20,000 lekë/muaj për një godinë ku zhvillohet aktiviteti privat i kopshtit, në emër të bashkëshortes. Akiviteti i biznesit ka nisur nga dt. 01.07.2005, por deklarohet në vitin 2006. Gjithashtu ka mungesë të dhënash mbi kostot e investimit të këtij aktiviteti, ndërkohë që në vitin 2010 deklarohen të ardhura nga shitja e aseteve dhe e paisjeve të biznesit prej 1,400,000 lekësh -blerja e të cilave nuk ishte deklaruar më parë.
Subjekti deklaron në vitet 2007-2008 shuma të dhëna hua prej 8,400,000 lekësh në total. Në vitin 2011, 7,000,000 lekë prej huave të kthyera janë përdorur për blerje apartamenti.